ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **2023/642-23-849-5-1-1/B05-0003321**

Sa i përket tenderit për: **Zgjerimi i rrjetit te Kanalizimit,pastrimi i kanalizimit,Pusetave dhe shtratit te lumejve në Qytet dhe Periferi.**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Gashi Ing " SH.P.K. & "DESHISHKU GB"

SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Radovan Zogoviq, 101/2/8

(Adresa)

Prishtinë — *(Vendi)*

10000 — *(Kodi postar)*

044/665544

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Gentian Deshishk

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@deshishkugb-ks.com

(Adresa elektronike)

12.10.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K DESHISHKU GB PRISHTINË

2. Identifikimi i avokat

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË** me datë **15.02.2023** ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **"Zgjerimi i rrjetit te Kanalizimit,pastrimi i kanalizimit,Pusetave dhe shtratit te lumejve në Qytet dhe Periferi"**, si në vijim:

- Procedurë e hapur,
- Kontrate publike - Kornizë
- Punë, Vlerë e Madhe
- Vlera e parashikuar e kontratës 550,000.00 euro
- Vlera e ofertes 9.85 euro
- Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët / çmimi i poentuar

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve i shkurtuar, data e dorëzimit 03.03.2023 ora:13:30, Vendi: E-platforma e Prokurimit.

Me datë: 05.04.2023 – Kemi pranuar Vendimin e AK-se, konkretisht ne kemi pranuar letren standarde per Tenderuesin e Eliminuar apo (te ashtuquajtur nga AK- Mitrovicë: Letren standarde për Tenderuesin e Papergjegjshëm).

Me datë: 07.04.2023 – Kemi parashtruar Kerkesë për Rishqyrtim

Me datë: 10.04.2023 – Kemi pranuar vendimin për refuzim te Kerkesës për Rishqyrtim nga AK – Mitrovicë

Me datë: 14.04.2023 – Kemi dorezuar Ankesë në OSHP

Me date: 28.04.2023 – Kemi pranuar **Ekspertizen nr. 2023/0206 – APROVIM** i ankesës tonë dhe Anulim i Vendimit të AK- Mitrovicë.

Me datë: 19.07.2023 – Kemi pranuar **Vendimin e PSH-së nr.: 2023/0206 - APROVIM** i ankesës tonë dhe Anulim i Vendimit të AK- Mitrovicë.

Me datë: 24.07.2023 - AK – Mitrovicë Anulon Vendimin dhe kthen lëndën në Rivlerësim.

Me datë: 22.09.2023 – AK – Mitrovicë Rivlereson dhe nxjerrë Vendim ne kundërshtim me vendimin e vet të datës: 05.04.2023 si dhe **në kundërshtim me vendimin e PSH-së nr.: 2023/0206**

Me datë: 26.09.2023 – Kemi parashtruar Kerkesë për Rishqyrtim

Me datë: 02.10.2023 - Kemi pranuar vendimin për refuzim të Kerkesës për Rishqyrtim nga AK – Mitrovicë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

4. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet.*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

5. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apoNjoftimit për Anulim.

□ **Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së)**

- Neni 1, Qëllimi, par 2 dhe 3.
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6;
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1

□ **Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP)**

- Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit, par, 43.5, 43.7
- Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d), (e), (h), (o).

□ **UDHËZUESI Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK.**

- Neni 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët, par 11.1

Mos respektimi i Vendimit të Panelit Shqyrtues, nr. OSHP:2023/0206 të datës: 19.07.2023

6. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesinsecilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

❖ **Pretendimi ynë** ankimor ka të bëjë me diskriminimin e vazhdueshëm që Autoriteti Kontraktues **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË** po bënë me dy vendime ndaj neve si Operator Ekonomik: **''Gashi Ing'' SH.P.K. & ''DESHISHKU GB'' SH.P.K.**

Me datë 05.04.2023 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues B58 dhe ne si operatorë ekonomik me ofertë të përgjegjshme me çmim më të lirë në këtë procedurë prokurimi, kemi pranuar letrat standarde për tenderuesin e eliminuar B42, **me arsyetimin plotesisht të pabazuar** kinse nuk kemi përmbushur Kapacitetin Teknik dhe Profesional respektivisht kontrata të ngjajshme në vlerën e kerkuar dhe këtë ne me plotë të drejtë e kundërshtuam dhe njëkohësisht e argumentuam edhe pse e argumentuar ka qenë me dorëzimin e ofertës tonë, mirëpo Autoriteti Kontraktues **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË** nuk e ka konsideruar si të tillë.
Mirëpo oferta jonë si e përgjegjshme **u argumentua nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik** sipas **vendimit: 2023/0206.** Përmes të cilit vertetohen në plotëni argumentet tona, anulohet vendimi i AK-së dhe lenda kthehet në Ri-vlerësim. **(shih më poshtë. Vendimin).**

Vendimi i Panelit Shqyrtues: 2023/0206

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljubljanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0206

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi - Anëtar, Vjosa Gradinaj - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Deshishku GB" sh.p.k., me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit,pastrimi i kanalizimit,Pusetave dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi", me numër të prokurimit 642-23-849-5-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Mitrovicë, me datën 19.07.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Deshishku GB" sh.p.k., me nr. 2023/206 , e datës 14/04/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi Komunal Mitrovicë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i rrjetit të Kanalizimit,pastrimi i kanalizimit,Pusetave dhe shtratit të lumejve në Qytet dhe Periferi", me numër të prokurimit 642-23-849-5-1-1, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet,në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP-së.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Deshishku GB" sh.p.k., me seli në Prishtinë.

Kryetar i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**
- OE - **DESHISHKU GB SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së:

TUTJE, **AK KUVENDI KOMUNAL MITROVICË** gjatë rivlerësimit në vend që të përmirësojë **gabimet e veta diskriminuese, të pabaza dhe joprofesionale** dhe të na shpallë ne si OE fitues, sepse jemi operatori ekonomik me çmimin më të lirë ***dhe i përgjegjshëm – tashmë kjo e argumentuar edhe nga dy shkallë shqyrtuese të OSHP-së.*** *Mirëpo AK – Mitrovicë prap vazhdon me vendim diskriminues ndaj nesh, madje tani* ***aplikon standarde të dyfishta në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, përkatësisht nenit 7 par1,2 dhe 6.*** *Ku fillimish sipas vendimit te datës 05.04.2023, na trajtoi të papërgjegjshëm në mënyrë të gabuar dhe jo të drejtë dhe të një anshme me arsyen* ***kinse nuk kemi permbushur Kapacitetin Teknik dhe Profesional respektivisht kontrata te ngjajshme ne vleren e kerkuar*** *dhe pas anulimitt të këtij vendimi nga* ***Paneli Shqyrtues i OSHP-së,*** *pastaj pas rivleresimit* ***AK – Mitrovicë nxjerr vendim të datës 22.09.2023 dhe tani ndërron arsyen e eliminimit – kinse për çmime jonormalisht të ulëta.*** *Pra nxjerr vendim në kundërshtim me vetëveten (sipas vendimit të parë) si dhe në kundërshtim me Vendimin e OSHP-së nr. 2023/0206.*

(Shih vendimin e datës: *22.09.2023)*

Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

Shiqo preambulen e Vendimit duke u thirrur në nenin 87 par 2, Rregulloren për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët Kjo rregullore tashmë e shfuqizuar.

Ne rast te anulimit te aktivitetit te prokurimit shëno arsyetimin për anulim n[i]:
Komisiomi i vlerësimit duke u bazuar në Rregulloren për Tenderët JO-Normalisht te Ulët ku KRPP në pajtim me Nenin 87 paragrafi 2 adapton,plotësonë dhe jep sqarime për tenderët JO-Normalisht te ulët.

A.K. Komuna e Mitrovicës JUGORE ka refuzuar tenderin me numer te prokurimit të lartë cekur si tender me qmimin më te ulët dhe lidhur me këtë ju sqarojmë dhe duke u bazuar në Nenin 3 Informatat e përgjithshme te Rregullat për Tenderët AB-Normalisht të Ulët dhe duke u bazuar në këtë nen dmth ne Paragrafin 3.1 te këti neni shifet shumë qartë se 3[tre] Operatorët Ekonomik me qmime AB normalisht te ulët cekur më lartë me qmimet e ofrura në oferten e juaj i përmbushni të gjitha kriteret dhe kushtet e mëposhtme për tenderëtAB-Normalisht te ulët si vijon:

SHPJEGIM: Komisiomi i **RI**-vlerësimit duke u bazuar në Rregulloren për Tenderët **JO**-Normalisht te Ulët ku KRPP në pajtim me Nenin 87 paragrafi 2 adapton,plotësonë dhe jep sqarime për tenderët **JO**-Normalisht te ulët sqaron dhe jep arsyetim si më poshtë:

A.K. Komuna e Mitrovicës së JUGUT ka refuzuar tenderin me numer te prokurimit të lartë cekur si tender me qmimin më te ulët dhe lidhur me këtë ju sqarojmë dhe duke u bazuar në Nenin 3 Informatat e përgjithshme te Rregullat për Tenderët JO-Normalisht të Ulët dhe duke u bazuar në këtë nen dmth ne Paragrafin 3.1 te këti neni shifet shumë qartë se 3[tre] Operatorët Ekonomik me qmime **JO** normalisht te ulët cekur më lartë me qmimet e ofrura në ofertat e tyrej i përmbushin të gjitha kriteret dhe kushtet e mëposhtme për tenderët **JO**-Normalisht te ulët si vijon:

i.Qmimi ofruar është më shumë se 30% më i ulët se qmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm,
ii. Qmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se qmimi ose kostot e tenderit te dytë më te ulët,
iii. Janë dorëzuar te paktën 3 (tre) tenderë-në rastin konkret janë dorëzuar 4 (katër) tenderë. Pasi tenderët e juaj të cekur më lartë sipas këti neni dmth sipas Nenit 3 paragrafi 1 te këtyre rregullave i plotëson të gjitha kushtet për të qenë TENDER AB-NORMALISHT I ULËT dhe duke u bazuar në besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe duke u bazuar në nenin 61 te LPP-së ne si AK kemi vërejtur se edhe qmimet e juaja për njësi ashtu edhe në total janë shumë te ulta.

Grup i Operatorëve Ekonomik GASHI ING SH.P.K; DESHISHKU GB Sh.p.k.Nebih Hodo Kuqi, Nr 3, Suharekë, kanë ofertuar me qmime **jo-normalisht te ulta** në këto pozicione si vijon: Nga pozicioni **poz.2.2 deri 2.6 nga 2.10 deri te poz.2.14,** dhe pozicionet **3.1;3.3;3.4;3.8,dhe nga poz.4.1 deri 4.17 qmime JO normalisht te ulta,**
kurse keni qmime shumë të **larta JO-normalisht te larta** në pozicionet si vijon: **1.3 enorm i lartë, qmime enorm të lartë,poz.3.2;3.5;3.10;3.15 qmime enorm te larta në krahasim me qmimet e tregut.**

Ne e kundërshtojmë vendimin e AK të datës: 22.09.2023 sepse, është nxjerrë në shkelje të dispozitave të lartë cekura, madje ky vendim **përveq që është diskriminues është edhe skandaloz** për faktin se është thirrur në ''Rregulloren për Tenderët Jo- Normalisht të Ulët e cila është e shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (RRPP) me datë: 01.11.2022 **(shih argumentin).**

Neni 102

Dispozitat e shfuqizimit

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen:

1. A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik – të datës 01.02.2021
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 1/2019
3. B57 Rregullat për tenderët Jo-Normalisht të ulët
4. F03 Rregullat për parashtrimin e ankesave
5. Rregullore Nr. 2/2017 për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikatës profesionale për prokurimin publik
6. B59 Rregullat për Shërbime të veçanta (Konsulentët/Kontraktorët individual) (18.11.2020).

Neni 103

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me 01 nëntor 2022.

z. Osman Vishaj

Kryetar i KRPP - së

Andaj i tërë vendimi i datës: 22.09.2023 është i pavlefshëm ligjërisht sepse të gjitha dispozitat ligjore paragrafet dhe nenet janë të dokumenteve të shfuqizuara.

Sidoqoftë ne i kemi bërë me dije AK – Mitrovicë se oferta jonë nuk ka të bëjë fare me çmime jonormalisht të ulëta dhe nuk plotësohet asnjëri prej kushteve për të konsideruar çmime jonormalisht të ulëta. *Pozicionet në këtë paramasë janë pozicione që ndërlidhen njëra me tjetrën në ekzekutimin e punimeve, dhe*

ne asnjë rastë nuk ekzekutohen veq e veq, dhe nëse e marrim një shembull për një punë që duhet të kryhet del që çmimet tona në total për kryerjen e punëve janë plotësisht në harmoni me çmimet e tregut, këtë e kemi dëshmuar shumë kjartë edhe në përgjigjen e derguar në AK- Mitrovicë, duke dëshmuar se jemi të gatshëm të përfundojmë këtë kontratë ***sepse kemi kapacitete teknike, profesionale dhe përvojë të specializuar në këtë lëmi, prandaj për t'iu siguruar juve ne kemi pranuar që që të dyfishojmë Sigurimin e Ekzekutimit.*** *Për më shumë* ***shih në vazhdim elaborimin e detajuar e të argumentuar bashkangjitur përgjigjen e derguar të datës: 03.09.2023.***

DESHISHKU GB

Data: 03.09.2023, Prishtinë

Nga: "Gashi Ing" SH.P.K. & "DESHISHKU GB" SH.P.K.

Për: Zyra e Prokurimit, Komuna e Mitrovicës

Tema: Pergjigjje në pytjet e AK për tenderin me titull: Zgjerimi i rrjetit te Kanalizimit,pastrimi i kanalizimit,Pusetave dhe shtratit te lumejve në Qytet dhe Periferi; Me nr. te prokurimit: 642-23-849-5-1-1.

Përgjigjja për kërkesën nr. 1:

Ne OE: "Gashi Ing" SH.P.K. & "DESHISHKU GB" SH.P.K., deklarojmë njëzëri që kemi plotësuar përshkrimin e çmimeve me vetëdije të plotë, dhe të njejtës i qëndrojmë mrapa.
Për të rritur besushmërin tuaj ndaj neve, ne jemi në gjendje të **dyfishojmë sigurimin e ekzekutimit** të tenderit vetëm për të ju bërë juve si AK të ndjeheni të sigurtë që nuk do të keni dëme eventuale në lidhje me këtë procedurë të prokurimit. Ne jemi OE serioz, ne do të jemi në gjendje të ekzekutojmë të gjitha kërkesat e juja gjatë ekzekutimit të punimve. Ne me bindje të plotë konsiderojmë që çmimet tona janë normale dhe nuk do ti shkaktojn dëme AK.

Në vendimin tuaj të datës: 05.04.2023 (Njotim mbi vendimin e AK për propozim për shpërblim me kontratë), i keni cilësuar si të përgjegjshëm këta dy OE: "Eurondertimi" dhe "Gani Mlinaku" B.I. Ndërsa neve si grup i OE na keni cilësuar të pa përgjegjshëm, pastaj ne kemi bërë ankesë në OSHP dhe e njeta e ka cilësuar ankesën tonë plotësisht të bazuar dhe i ka hedhur poshtë pretendimet e juaja.

Në këtë procedur të prokurimit si mbas vednimit tuaj te datës 05.04.2023, dhe si mbas vendimit të OSHP-së të datës: 19.07.2023, jemi tre OE të përgjegjshëm, me çmime si në vijim:

10.15€ "Eurondertimi"
9.85€ "Gashi Ing" SH.P.K. & "DESHISHKU GB" SH.P.K.
12.62€ "Gani Mlinaku" B.I.

32.62€ Vlera totale e çmimit të përbashkët e tre OE.

Mesatarja e çmimit ofertues të tre OE: 10.87€ – 30% = 7.60€, ndërsa ne e kemi çmimin 9.85€, çmimi i ofertuesit të dytë me radhë: 10.15€ - 10% = 9.13€, që do të thotë se asënjëri kusht nuk është plotësuar që ne të jemi me çmim jo-normalisht të ulët, pretendimin tuaj e konsiderojmë të pa bazë.

Përgjigjja për kërkesen nr. 2 :

Pozicionet 2.2 deri 2.6 në këto pozicione nuk i konsiderojmë si pozicione me çmime të ulëta, nga arsyja se si pozicione në totalë për tu ekzekutuar punimet e kanalit për kanalizim për 1m', totali i ofertës tonë sillet mbi 36€ per 1m', që do të thotë se mbulohen të gjitha shpenzimet e OE për ekzekutim të punimeve dhe do të japë një profit solid per neve si OE.

SH P DESHISH PRISHT

Pozicionet 2.1 deri 2.14; 3.1; 3.3; 3.4; 3.8 dhe pozicionet 4.1 deri 4.17 (ne paramasë këto pozicione janë emruar: 4.1 deri 4.5 dhe 4.1 deri 4.7)
Të gjitha këto pozicione me çmime të ulëta me prejashtim të pozicioneve 2.12 dhe 3.8 janë të ndërlidhura me pozicionet tjera siq janë: 1.2; 1.13; 2.2; 2.3; 2.5; 2.6; 2.7; 2.9; 2.10 etj. Të gjitha këto pozicione me çmime të ulta dhe pozicionet me çmime pak më të larta, për tu ekzekutuar ndërlidhen njëra me tjetrën, dhe si të tilla janë çmime të arsyshme të tregut dhe do të japin gjatë ekzekutimit të punimve profit solit për neve si OE.

Si shembull i ndërlidhjes së pozicioneve njërin me tjetren po e marrim mesataren e gypave të kanalizimit PSN8 nga pozicioni 4.1 deri 4.7 (si çmime të ulta). Si mesatare e diametrit të gypave po e marrim gypin fi 315 mm – me pozicion 4.3. Per tu furnizuar me këtë gypë, zhavor dhe me materiale tjera të nevojshme, shpenzimet për ekzekutim të kanalizimit do të kushtojnë rrethë 47.75€, ndërsa totali i çmimeve të ofertës tonë për ekzekutimin e 1m' të kanalizimit me gyp PSN8 fi 315mm me të gjitha pozicionet e nevojshme arrin vlerën e përafërt të ofertës rrethë 55.48€. Që domethanë mesatarja e çmimve të ofertuara për njeë 1m' të kanalizimit është 55.48€. Profiti për bizneset tona, per 1m' do të jetë 7.73€ për m1'.
Më poshtë po paraqesim pozicionet me çmime të ulta dhe më të lartë të cilat lidhen me këtë aktivitet, si dhe paraqesim çmimet për secilin pozicion si mbasë ofertës tonë:
Pozicioni 1.2 eshte ofertuar me çmim 3€
Pozicioni 1.3 eshte ofertuar me çmim 9.80 €
Pozicioni: 2.2; 2.3; 2.4 (pozicionet për germim) është ofruar me çmim 15.10€/ 3 pozicione =5.03€
Pozicioni 2.5 eshte ofertuar me çmim 26€
Pozicioni 2.6 eshte ofertuar me çmim 10€ m3, ndersa nevoiten 0.3m3 per nje 1m' që kushton 3€
Pozicioni 2.7 eshte ofertuar me çmim 0.15€
Pozicioni 2.9 eshte ofertuar me çmim 8€
Pozicioni 2.13 është ofertuar me çmim 0.10€
Pozicioni 2.14 është ofertuar me çmim 0.10€
Pozicioni 3.1 eshte ofertuar me çmim 0.10€
Pozicioni 4.4 eshte ofertuar me çmim 0.20€
Totali i cmimve per 1m' si mabs ofertes: 55.48€

Më poshtë po paraqesim konston e furnizimit të materialeve dhe vendosjen në vepër të pozicioneve të më sipërme:
Pozicioni 1.2, kostoja e ekzekutimit të punimve 1.2€
Pozicioni 1.3, kostoja e ekzekutimit të punimve 1.4€
Pozicioni: 2.2; 2.3; 2.4 (pozicionet për germim) kostoja e ekzekutimit të punimve 4€
Pozicioni 2.5 kostoja e ekzekutimit të punimve 3€
Pozicioni 2.6 kostoja e ekzekutimit të punimve 2€
Pozicioni 2.7 kostoja e ekzekutimit të punimve 0.15€
Pozicioni 2.9 kostoja e furnizimit dhe ekzekutimit 7€
Pozicioni 2.13 kostoja e ekzekutimit të punimve 1€
Pozicioni 2.14 kostoja e furnizimit dhe ekzekutimit 9€
Pozicioni 3.1 kostoja e furnizimit dhe ekzekutimit 10€

DESHISHKU GB

Pozicioni 4.4 kostoja e furnizimit dhe ekzekutimit 9€
Totali i kostos per furnizimin dhe ekzekutimin e kanalizimit per 1m': 47.75€

Përgjigjja për kërkesen nr. 3:

Ne si OE kemi eksperince te mjaftushme dhe kapacitete profesionale, teknike dhe financiare per te ekzekutuar tenderin ne fjale me shume sukses. Ne konsiderojm qe çimet tona jane te favorshme per AK si dhe per neve si OE, te njetat poashtu jane cmime te tregut dhe shume normale.
Nëse shperblehemi me kontratë, punimet do të ekzekutohen si mbas kërkesave të dhëna nga menaxheri i projekit, duke bërë organizimin e personelit dhe makierisë së nevojshme për ekzekutimin e punimeve. Ne me bindje të plotë konsiderojmë që çmimet tona janë normale, favorshme per AK si dhe per neve si OE.

Vëmendje:

Ju si AK, letren standarte e kërkesës për informata mbi tendet jo-normailisht të ulët dhe jo-normalisht të lartë, e keni formuluar me datë 31/08/2023, ndërsa neve na keni derguar përmes e-prokurmit me datë 01/09/2023, në ora 16:17, ditë e premte, mbasë orarit të punës, ndërsa keni kërkuar që informatat duhet të ngarkohen mbrenda 3 ditëve nga data e kësaj kërkese (31/08/2023). Konsiderojmë që këtë kërkesë e keni derguar qëllimisht një ditë mbasë formolimit të sajë, dhe të njejten e keni ngarkuar mbasë orarit të punës me qëllim që ne mos të mundemi të ju japim një përgjigjje.

Mbetemi me shpresë që sqarimet tona të shqyrtohen me kujdes dhe në mënyrë të drejt, dhe të na shpërbleni me Kontratë në mënyrë që ne mos të kemi nevojë që të bëjmë ankesë në OSHP, padi në Gjykatatë kometente për ecurin e kësaj procedure të prokurimit dhe për dëmet matriale dhe dëmet e imazhit që na janë shkaktuar, si dhe shqetësimet tona do ti shpalosim te mediet të cilat i trajtojnë këto qështje.

"DESHISHKU GB" SH.P.K.

Përgjigjet e derguara nga ana e jonë janë plotësisht të arsyeshme, të argumentuara dhe tregojnë seriozitetin e kompanisë tonë në kryerjen e këtyre punëve për çka ne jemi të specializuat në këtë lëmi si nga ana e kapaciteteve teknike profesionale poashtu edhe nga ana e resurseve njerëzore profesionale. Siç shihet edhe në shkresën e lartëcekur këtu kemi të bëjmë me ndërlidhshmëri të pozicioneve në kryerjen e punëve sepse kjo kontratë është ''Punë'' dhe për të kryer 1m kanalizim duhet bërë gërmimi i kanalit, planifikimi i fundit të kanalit si dhe shtrija e zhavorit si dhe instalimi i gypave te kanalizimit, mbulimi me zhavor si dhe mbulimi i kanalit me dhe ose me zhavor varsisht nga vendi ku ekzekutohen punimet...etj pra domosdo nërlidhen një mori pozicionesh për të kryer këto punë, prandaj nuk mundet në këtë llojë kontrate të konsiderosh një pozicionë si abnormalisht të ulët pa marrë në konsideratë edhe pozicionet tjera që ndërlidhen për të ekezekutuar në shembullin më të thjeshtë 1m kanalizim, në ekzekutimin e 1m' kanalizim nga fillimi deri në përfundim del që çmimet tona janë në harmoni me çmimet aktuale të tregut.

Vlenë të theksohet që AK – Mitrovicë ka formuluar Letren Standarte për informata tender jo-normalisht të ulët, me datë 31.08.2023, ndesra neve na ka derguar me datë 01.09.2023 (ditë e premte) në ora 16:17, ndëssa ka kërkuar qe informatat e kërkuara të dergohen brenda 3 ditëve nga data e kësaj kërkese (31.08.23). Ne konsiderojm qe AK me qellim na ka derguar pytje ne kohën e pushimt me qëllim që ne mos te arrijmë të përgjigjemi me kohë dhe si duhet, pastaj qëllimi AK të shpërblej me kontratë prapë OE që e ka shpallur ne vendimin e datës 05.04.2023.

Andaj, refuzimi i shkresës së lartëcekur me përgjigje të argumentuara si dhe refuzimi i Kërkesës për

*Rishqyrtim, me arsyetimet nga ana e **AK – Mitrovicë** të pa bazuara, të pa argumentuara, tendencioze, vetëm e shpërfaqin tanimë hapur **DISKRIMINIMIN që po na bëhet neve si Operatorë Ekonomik, në kundërshtim me Neni 7, par 1,2, 4 dhe 6 të LPP-së**. Ndrrimi i arsyetimit për eliminim sipas **vendimit të datës: 05.04.2023** dhe tani sipas **vendimit të fundit: 22.09.2023** ndaj nesh tregon joseriozitetin, jo profesionalizmin e AK – Mitrovicë **tanimë duke nxjerr vendim të bazuar në nene, paragrafe dhe dokumente të shfuqizuara** si dhe në kundërshtim* dhe në shkelje të dispozitave të **par (d), (e), (h), (o), të nenit 97 të rregullores RRPP-së nr.001/2022.**

Gjithashtu arsyetimi i Autoritetit Kontraktues në refuziminin e Kërkesës për Rishqyrtim, se kinse kemi dërguar dokumentin në KRPP dhe kemi pritur afatin e kthimit të përgjigjeve të tyre, theksohet me qëllim që të krijohet hamendje tek ne, mirëpo ne ju sqarojmë se jemi mjaftë vigjilent dhe e dijmë shumë mirë se është kjo vetëm një veprim procedural obligativ për çdo autoritet kontraktues kurdo që refuzon një tender për çmime jonormalisht të ulëta dhe përgjegjësia për këto veprime i takon vetëm Autoritetit Kontraktues, andaj është e kotë të përmendet ky veprim procedural i AK-së në mënyrë që të tingëllojë e të krijojë hamendje se kinse Vendimi i AK-së është i arsyeshëm.

*Anulimi i procedurës së prokurimit nga AK – Mitrovicë, në mënyrë diskriminuese ka vetëm një arsye të vërtetë dhe ajo është: vetëm se ne jemi me çmimin më të lirë si ofertë plotësisht e përgjegjshme. Pota shikosh vetëm renditjen e çmimeve dhe diferencën e ngushtë të tre ofertuesve të parë në procesverbalin e hapjes tregon se çmimet janë reale, në harmoni me çmimet aktuale të tregut dhe nuk ka të bëjë fare me çmime jonormalisht të ulëta. **(Shih më poshtë renditjen e ofertuesve.)***

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues : **Zgjerimi i rrjetit te Kanalizimit,pastrimi i kanalizimit,Pusetave dhe shtratit te lumejve në Qytet dhe Periferi.**

Nr. i prokurimit[1]	642-22-849-5-1-1
Nr i brendshëm	642/22/025/511

Radhë	Emri dhe Adresa e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në tender [procedur].	Vlera totale e ofertes
1.	"EURONDERTIMI" SH.P.K. Rr. Azem Behrami, Mitrovica 810108995	10.15
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik GASHI ING SH.P.K; DESHISHKU GB SH.P.K. Nebih Hodo Kuqi, Nr 3, Suharekë	9.85
3.	Gani Mlinaku B.I. PARKU FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, MITROVICË 810559263	12.62
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Valdrini sh.p.k; Luigj Kastrati B.I. FEHMI LLADROVCI BLLOKU 7 BANESA 4, GLLOGOC	133.17

*ME këtë diferencë të ngushtë të çmimeve nuk mund të plotësohen **kushtet si në shembullin 1** të ilustruar në mënyrë të kjartë në **Nenin 11. par, 11.1 Tenderët Jo-normalisht të Ulët të UDHËZUESIT Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK.** Pra AK – Mitrovicë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura dhe nuk ka ofruar asnjë llogaritje se si ka ardhur deri te çmimet jonormalisht të ulëta, mirëpo këtë konstatim e ka të bazuar vetëm në mënyrë hipotetike.*

Poashtu ju njoftojm që me datë 24.07.2023 e kemi njoftuar AK-Mitrovicë që jemi në pritje të na njoftoni se sa duhet të zgjasim sigurimin e tenderit pasi i njejti i ka skaduar afati dhe kemi kërkuar të na njoftojnë sa sa duhet të zgjasim sigurimin e tenderit, AK nuk na është pergjigjur fare, ne kemi pritur një përgjigje por e njeta nuk na është derguar nga AK, pastaj ne me date 21.08.2023 e kemi zgjatur sigurimin e tenderit per 120 ditë. Ne konsiderojm që AK e ka për obligim të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit, në rastin tonë dyshojmë që AK me qëllim nuk ka kthyer përgjigjjen tonë, që pastaj të gjejë arsyje të na eliminoj si të papergjegjshëm. (dështmin e kërkesës e gjeni të ngarkur)

Andaj, vendimi i AK- Mitrovicë është i Pa Bazuar.

Dihet mirë se kur mund të anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes së ofertave:
Pra, Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, par 1, 1.1, 2, 2.1 si dhe nenit 43 të RRPP-s, par, 43.5, 43.7, nxjer vendim mbi Anulimin e aktivitetit të prokurimit, ***i kujtojmë AK se çdo veprim jashtë këtyre neneve është në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar në fuqi*** *për Prokurim Publik, andaj AK nxjerr vendim të pabazuar në legjislacion, të pa argumentuar* ***dhe madje të bazuar në dokumente të shfuqizuara.***

Prandaj, me te drejtë e kundërshtojmë vendimin e AK të datës: 22.09.2023 sepse, është nxjerrë në shkelje të dispozitave të lartëcekura dhe në shkelje të dispozitave **par (d), (e), (h), (o), të nenit 97 të rregullores RRPP 01/2022**, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe në trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit.

Rrjedhimisht, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ta trajtojë **Ankesën** në kuptim të nenit 4.3.të **RRPP 01/2022**, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, prandaj kërkojmë nga OSHP-së, ta analizojë ecurinë e procedurës dhe ta sheh diskriminimin e vazhdueshëm që po na bëhet tashmë me dy vendime nga AK- Mitrovicë, dhe ta trajton në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-se dhe rregulloreve në fuqi dhe argumenteve të prezantuara dhe ti korigjojë, veprimet diskriminuese dhe të njëanshëm të Autoritetit Kontraktues. duke nxjerrë vendim:

VENDIM

- Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj **Ankesën** të bazuar tëparaqitur nga **''Gshi Ing'' SH.P.K. & DESHISHKU GB SH.P.K.**
- Te anuloj vendimin e AK – **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**, të datës 22.09.2023 sepse **''Gashi Ing'' SH.P.K. & ''DESHISHKU GB'' SH.P.K.** ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;
- Dhe gjatë rivlerësimit të nxjerrë vendim meritor duke shpërblyer me kontratë Operatorët e përgjegjshëm me çmim më të ulët: **''Gashi Ing'' SH.P.K. & ''DESHISHKU GB'' SH.P.K.**

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.
Me respekt,

Gentian Deshishk

7. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet, shpenzimet në Sigurimi i Tenderit, Kostoja e përgatitjes së Ankesës, Stresi dhe depresioni që po përjetojmë nga diskriminimi i vazhdueshëm Dokumentet për përgatitjes e tenderit për konkurim. Dëmi ekonomik dhe finaciar i fitimit të planifikuar, Humbja e imazhit etj.

8. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim". një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
c) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohe*